



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:163941
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05448383

KA.nr.315/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Amis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Klan Kosova” SH.P.K., me seli në Zonën Industriale, ish – Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë, me numër unik identifikues 810795297, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu & Qerkini” SH.P.K. me seli në Veternik, kompleksi banesor EXDC3, blloku 10, kati VI, nr.18, Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, me seli në rr. “Abënor e Astrit Dehari”, nr. 21, Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.Xh. nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. 4566/01 të datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit Nr. 309/11 të datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 21.02.2024, në prezencë të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit, më datë 13.03.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Klan Kosova” SH.P.K., ANULOHEN Vendimi Nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimi Nr. 309/11 i datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë pranë të paditurit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- II. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.
- III. Shtyrja e ekzekutimit të Vendimit nr. 4566/01 të datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 309/11 të datës

14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.315/23 i datës 02.08.2023, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi “Klan Kosova” SH.P.K., me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e Vendimit nr. 4566/01 të datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 309/11 të datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK). Paditësi ka theksuar se gjatë historianit të saj biznesor ka pësuar ndryshim në strukturën e biznesit, ndryshime këto të cilat janë reflektuar sipas kërkesave të subjektit juridik “Klan Kosova” SH.P.K., e të cilat janë aprovuar nga ARBK. Ka shtuar se ndër ndryshimet ishte edhe ai i vitit 2021, ku 100% e aksioneve të paditësit kishin kaluar në pronësi të personit juridik “KGO Media Investments Holding” SH.P.K., kompani kjo e regjistruar në ARBK në përputhje me legjislacionin në fuqi. Më tej ka shtuar se “KGO Media Investments Holding” sipas statutit të saj kishte përcaktuar si themelues kompaninë “KGO Media Investments Holding” DOOEL, me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me pronarë K.G.. Gjatë regjistrimit të kompanisë “KGO Media Investments Holding” DOOEL, në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2016, ishte autorizuar një kompani ligjore e meqë pronari i kësaj kompanie K.G. kishte dy shtetësi atë të Kosovës dhe të Serbisë, me rastin e regjistrimit ishte përdorur kjo e fundit, mirëpo thekson se përkundër kësaj “KGO Media Investments Holding” SH.P.K., në Kosovë ishte regjistruar si etnitet i ri dhe jo si degë e kompanisë në Maqedoni dhe as si investitor i huaj duke shtuar se “Klan Kosova” është kompani mediale e cila është themeluar dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me dispozitat ligjore dhe është në pronësi të “KGO Media Investments Holding” SH.P.K. Paditësi pretendon se përmes vendimit të kontestuar me padi, i padituri ka aplikuar gabimisht dispozitat e të drejtës materiale, shkelje të dispozitave procedurale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Sipas paditësit, i padituri gjatë shqyrtimit të ankesës nuk ka marrë për bazë asnjë rrethanë faktike të paraqitura në të njëjtën dhe as provat e paraqitura në ankesë, po ashtu ka shtuar se vendimi i drejtorit të përgjithshëm të ARBK është në kundërshtim me dispozitat ligjore ashtu që ka tejkaluar kompetencat ligjore, duke vendosur kushte të cilat nuk janë të përcaktuara me ligj në mënyrë shprehimore. Si dhe ka shtuar se nuk qëndron arsyetimi i të paditurit se është cenuar sovraniteti i Republikës së Kosovës. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se vendimi i të paditurit është arbitrar dhe nuk gjen mbështetje ligjore, duke shtuar se neni 4 i Ligjit

për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton qartë se veprimi administrativ që cenon apo mund të cenoj një të drejtë apo një interes të palës duhet të jetë i autorizuar nga një ligj, në rastin konkret e kemi një vendim të administratës shtetërore dhe me të është cenuar një interes juridik i paditësit. Tutje ka theksuar se vendimi për pezullimin e certifikatës së biznesit të paditësit “Klan Kosova”, nuk është i parashikuar me asnjë dispozitë ligjore. Ka shtuar se përmes vendimeve të kontestuara i padituri po e mban përgjegjës paditësin për të dhënat e regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pra për veprime të cilat janë jashtë kontrollit të paditësit, por edhe të paditurit sepse bëhet fjalë për një organ administrativ të shtetit të huaj. Ndërkaq sa i përket pretendimeve të palës së paditur, se paditësi ka ndërmarr një veprim që bie ndesh me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës janë në tërësi të pa bazuara, pasi që sipas paditësit rendi kushtetues i Republikës së Kosovës gëzon mbrojtje penale juridike. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të anulojë Vendimin nr. 4566/01 të datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimin nr. 309/11 të datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e ARBK.

I padituri përmes përgjigjes në padi, ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar padinë e paditësit duke theksuar se i padituri pas ri-verifikimit të dosjes së biznesit “Klan Kosova”, tani paditës ka vërtetuar se i njëjti me rastin e regjistrimit në periudha të ndryshme kohore ka ofruar dokumentacion i cili në përmbajtje është i pasaktë dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe në kundërshtim me parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për shkak se të dhënat e paraqitura në certifikatën e biznesit, përkatësisht te ndërrimi i pronarëve është paraqitur emri i Komunës Pejë dhe Gjakovë, kurse shteti Serbia. I padituri konsideron se një veprim i tillë, më saktësisht përmbajtje të tilla ku përdoret emri i Qytetit/Komunës së Republikës së Kosovës, kurse shteti i Republikës së Serbisë, konsiderohet si veprim me të cilin Institucionet e Administratës Shtetërore të Kosovës, pranojnë se qytetet e Kosovës janë nën administrimin e Republikës së Serbisë, e që këto veprime janë në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe dispozitat ligjore në fuqi. Tutje thekson se ky nuk është një gabim teknik i cili mund të përmirësohet mirëpo kjo paraqet kërcënim ndaj sigurisë publike, andaj konsideron se vendimet e kontestuara kanë qenë të domosdoshme. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesit me autorizim ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit “Klan Kosova” pasi që konsideron se e njëjta nuk ka bazë ligjore duke ritheksuar se Vendimi me Nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 dhe Vendimi me Nr. 309/11 i datës 14.06.2023 janë plotësisht të mbështetura në dispozita ligjore.

Ka theksuar se i padituri ka gjetur se paditësi me rastin e regjistrimit në periudha të ndryshme kohore ka ofrua dokumente të ndryshme i cili në përmbajtje është i pa saktë dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare si dhe në kundërshtim me parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për shkak se të dhënat e paraqitura në certifikatën e biznesit përkatësisht ndërrimi të pronareve është paraqitur emri i Komunës së Pejës dhe Gjakovës kurse shteti Serbi duke konsideruar se paditësi me këtë ka bërë një mohim të shtetësisë së Republikës së Kosovës. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia dhe padia e paraqitur nga paditësi të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim mbi pezullimin e certifikatës së biznesit të kompanisë “Klan Kosova” SH.P.K; Nr. 309/11 i datës 14.06.2023; Vendim për korrigjim Nr.prot. 311 i datës 15.06.2023; Vendimi Nr.prot. 333 i datës 21.06.2023; Vendim Nr. 336 i datës 21.06.2023; Ankesë me Nr.prot. 3769/02 i datës 29.06.2023; Vendim Nr. 14118/01 i datës 11.07.2023; Vendim Nr. 4566/01 i datës 28.07.2023; Vërtetim i regjistrimit tregtar dhe regjistrimit të etniteteve ligjore të tjera i lëshuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut i datës 20.06.2023 dhe përkthimi në gjuhën zyrtare; Certifikatë e regjistrimit të biznesit në ARBK për “KGO Media Investments Holdings” SH.P.K e lëshuar nga ARBK e datës 31.05.2021; Pasaportë për K.G. dhe Vërtetim i noterizuar nga Noteri Burim Xhemajli; Certifikatë e regjistrimit të biznesit në ARBK për “Klan Kosova” SH.P.K e datës 29.05.2020 dhe Informatat për biznesin; Lisat e pagave për tatim paguesin “Klan Kosova” SHPK ; Vërtetim tatimor për “Klan Kosova” SHPK i datës 30.07.2023; Certifikatë e licencës së KPM për ofertues të shërbimeve mediale audiovizuale “Klan Kosova” SH.P.K e datës 27.02.2019; Aplikacioni për regjistrimin të ndryshimeve në biznesin “Klan Kosova” SH.P.K i datës 21.06.2023; Konfirmim nga ARBK për dorëzim të aplikacionit i datës 21.06.2023 dhe informatat sipas aplikacionit; Vendim mbi korrigjimin e të dhënave personale i nxjerr nga “Klan Kosova” SH.P.K i datës 20.06.2023; Grafikë e strukturës së pronësisë së “Klan Kosova” SH.P.K dhe dokumentacioni i bashkangjitur për pronësinë; Aplikacion për ndryshimin e të dhënave mbi pronësinë dhe e drejtorit dhe përfaqësuesit i datës 27.04.2020 dhe dokumentacioni i bashkangjitur aplikacionit; Marrëveshje për transferimin e aksioneve i datës 17.04.2020; Fletëparaqitje për regjistrim fillestar për biznesit “Klan Kosova” SH.P.K i datës 16.08.2013; Vendim mbi ndryshimin dhe plotësimin e statutit të “Klan Kosova” SH.P.K i datës 14.08.2013; Vendim mbi aprovimin dhe plotësimin e statutit të “Klan Kosova” SH.P.K 14.08.2013; Kontratë për shitblerjen e aksioneve i datës 01.01.2013 dhe vërtetimi noterial i kësaj kontrate nga Noteri

Bashkim Stavileci; Aneks statuti i datës 14.08.2013; Vërtetim nga ARBK mbi ndërrimin e pronarëve të “Klan Kosova” SH.P.K e datës 31.01.2014; Aneks statuti i datës 29.01.2014; Certifikata e regjistrimit të biznesit “Klan Kosova” SH.P.K dhe informatat e biznesit lëshuar me datë 03.12.2008; Aplikacion për ndërrim të pronarëve i datës 31.01.2014 dhe dokumentacioni i bashkangjitur aplikacionit; Kontratë mbi faljen e aksioneve i datës 29.01.2014; Vendim mbi ndryshimin dhe plotësimin e statutit të “Klan Kosova” SH.P.K i datës 29.01.2014; Vendim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut për subjektin “K Media Corporation” SH.P.K.NJ.P. me seli në Shkup lëshuar me datë 28.01.2014; Aplikacion për ndërrimin e pronarëve të “Klan Kosova” SH.P.K e datës 11.10.2021; Vendim mbi ndryshimin dhe plotësimin e statutit të “Klan Kosova” SH.P.K i datës 01.10.2021; Kontratë për shitblerjen dhe transfer të aksioneve i datës 01.10.2021; Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar i biznesit “Klan Kosova” SH.P.K i datës 01.10.2021; Aplikacioni për ndërrim adrese i datës 05.07.2019; Vendim për ndryshim statuti i datës 14.02.2019 dhe Statuti i datës 15.02.2019; Aplikacion për regjistrim të ndryshimeve në biznesin “Klan Kosova” SH.P.K i datës 08.06.2023 dhe dokumentacioni i bashkangjitur aplikacionit; Fletëparaqitja për ndërrim të pronarëve i datës 03.12.2015 dhe dokumentacioni i bashkangjitur aplikacionit; Historia e biznesit “Klan Kosova” SH.P.K i lëshuar nga ARBK i datës 08.08.2023; Fletëparaqitja për regjistrim fillestar për “Klan Kosova” SH.P.K i datës 26.11.2008; Vendim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut për subjektin “K MEDIA Corporation” SH.P.K.NJ.P. me seli në Shkup lëshuar me datë 16.01.2014.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të përfaqësuesve të palëve në padi dhe përgjigje në padi si dhe deklarimeve në seancë si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e bazuar.

Gjykata konstatoi se me Vendimin Nr. 309/11 të datës 14.06.2023 të nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë, i padituri kishte pezulluar certifikatën e biznesit të kompanisë “Klan Kosova” SH.P.K. të lëshuar me datë 29.05.2020, me arsyetimin se në certifikatën e biznesit tek ndërrimi i pronarëve figuron vendbanimi Pejë – Serbia dhe Gjakovë - Serbia, dhe meqë nuk lejohet regjistrimi i një biznesi ku vendbanimi i cili është në kundërshtim me parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi që nga këto të dhëna mund të kuptohet se qyteti i Pejës dhe Gjakovës është nën administrimin e Republikës së Serbisë.

Ky vendim ishte korrigjuar në kuptim të bazës ligjore, përmes Vendimit për korrigjim Nr.prot. 311 të datës 15.06.2023, ndërkaq me Vendimin Nr.prot.333 të datës 21.06.2023, i padituri kishte shfuqizuar vendimin mbi pezullimin e certifikatës së biznesit së paditësit me arsyetimin se paditësi kishte paraqitur kërkesë për korrigjim të dokumentacionit dhe meqë kanë ndryshuar faktet, i padituri ka vlerësuar se nuk është i nevojshëm pezullimi i certifikatës së biznesit.

Gjykata konstaton se me Vendimin Nr.336 të datës 21.06.2023, i padituri kishte anuluar Vendimin nr.prot. 333 të datës 21.06.2023, për shkak të mungesës së ligjshmërisë dhe se zbatimi i të njëjtit do të përbënte veprë penale, duke lënë në fuqi Vendimin Nr. 309/11 të datës 14.06.2023.

I pakënaqur, paditësi kishte ushtruar ankesë me nr. prot. 3769/02 me datë 29.06.2023, me të cilën kishte kërkuar anulimin e Vendimit Nr. 309/11 të datës 14.06.2023 dhe Vendimit nr. prot. 333 të datës 21.06.2023.

I padituri duke vepruar sipas ankesës së paditësit kishte nxjerr Vendimin Nr.4566/01 të datës 28.07.2023, me të cilin kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar padi në gjykatë duke e kontestuar ligjshmërinë e tyre.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimeve të goditura me padi në kuptim të nenit 47 par. 5 të Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare (LSHT) i cili përcakton se: *“5. Nëse Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve refuzon ankesën e palës apo nuk përgjigjet në ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dorëzimi i ankesës, parashtruesi i ankesës mund t'i drejtohet gjykatës kompetente sipas ligjit në fuqi për konfliktin administrativ”,* dhe nenit 13 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *“1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.”*

Gjykata i vlerësoi në tërësi si të bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat kanë mbështetje në gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata sipas provave të administruara në këtë çështje dhe dispozitat ligjore materiale që rregullojnë këtë çështje.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga Certifikata e regjistrimit të biznesit “Klan Kosova” SH.P.K dhe informatat e biznesit lëshuar me datë 03.12.2008, gjykata konstaton se paditësi ishte regjistruar pranë të paditurit më 03.12.2008, me pronarë A.F., i cili përmes kontratës së shitblerjes së aksioneve kishte shitur aksionet tek personi fizik F.N., i cili përmes kontratës për faljen e aksioneve me datë 31.01.2014 kishte bartur pronësinë e aksioneve tek “K – Media Corporation” SH.P.K., me seli në Shkup.

Nga Certifikat e regjistrimit të biznesit në ARBK për “Klan Kosova” SH.P.K., e datës 29.05.2020 dhe Informatat për biznesin, gjykata konstaton se pronarë i “Klan Kosova” SH.P.K., është personi juridik “KGO Media Investments Holding” Sh.p.k., me numër unik identifikues 811575804 me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë.

Nga Certifikata e regjistrimit të biznesit në ARBK për “KGO Media Investments Holdings” SH.P.K., gjykata konstaton se pronarë i “KGO Media Investments Holdings” SH.P.K., është personi juridik “KGO Media Investments” DOOEL, me seli në Shkup, Maqedonia e Veriut, me pronarë K.G..

Nga Vërtetimi i regjistrimit tregtar dhe regjistrimit të etniteteve ligjore të tjera i lëshuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut i datës 20.06.2023, gjykata ka konstatuar se shoqëria “KGO Media Investments” LLCSP, është shoqëri tregtare e regjistruar në Maqedoninë e Veriut me datë 24.03.2016, me seli në “Partizanski Odredi Blvd” nr. 143, Shkup – Karposh, në pronësi të K.G., me adresë në rr. Faik Konica, nr. 21, Gjakovë, Kosovë.

Nga Certifikata e licencës së Komisionit të Pavarur për Media për ofertues të shërbimeve mediale audiovizuale “Klan Kosova” SH.P.K e datës 27.02.2019, gjykata konstaton se paditësi është i pajisur me licencë për ofertuesin e shërbimeve mediale, për transmetimin e programit përmes sistemit të operatorit të shpërndarjes.

Nga Aplikacioni për regjistrimin të ndryshimeve në biznesin “Klan Kosova” SH.P.K i datës 21.06.2023, gjykata konstaton se paditësi ka paraqitur aplikacionin për ndryshimin e të dhënave të pronarit të fundit, pronarit fizik K.G., ndryshim i cili ka të bëjë me ndërrimi i pasaportës në informatat e biznesit tek “KGO Media Investments” DOOEL, si dhe korrigjimi i adresës, ashtu që është kërkuar që të bëhet zëvendësimi i pasaportës së Republikës së Serbisë me pasaportën e Republikës së Kosovës si dhe ndryshimi i adresës së vendbanimit.

Nga Vendimi mbi korrigjimin e të dhënave personale i nxjerr nga “Klan Kosova” SH.P.K i datës 20.06.2023, gjykata konstaton se paditësi ka bërë korrigjimin e të dhënave personale, në kuptim të ndryshimit të pasaportës së pronarit K.G., ashtu që është bërë zëvendësimi i pasaportës së vjetër me pasaportën e re.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri në procedurë administrative ka bërë zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, përkatësisht nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) dhe Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, gjë që ka rezultuar në nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme nga i padituri në procedurë administrative.

Gjykata nga provat e administruara në këtë çështje ka konstatuar se në bazë të Certifikatës së Regjistrimit nr. ser. 10076953 dhe informatat e biznesit të lëshuara me datë 21.06.2023, “Klan Kosova” SH.P.K., është shoqëri tregtare e regjistruar në Kosovë me datë 26.11.2008, me numër unik identifikues 810795297 me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë, në pronësi të “KGO Media Investments Holding” SH.P.K., me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë dhe person të autorizuar B.I. me adresë rr. “Xheladin Hana” nr. 10, Pejë, Kosova. Sipas Certifikatës së Regjistrimit nr. ser. 10114386 dhe informatat e biznesit të lëshuara me datë 21.06.2023 për shoqërinë “KGO Media Investments Holding” SH.P.K., gjykata konstatoi se e njëjta është shoqëri tregtare e regjistruar në Kosovë me datë 31.05.2021 me numër unik identifikues 811575804 me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë, në pronësi të “KGO Media Investments” LLCSP, me seli në Karposh Partinzanski Odredi Blvd, nr. 143, Shkup, Maqedoni e Veriut dhe me person të autorizuar K.G. me adresë rr. “Faik Konica” nr. 21, Gjakovë, Kosova. Gjykata po ashtu ka konstatuar se shoqëria “KGO Media Investments” LLCSP, është shoqëri tregtare e regjistruar në Maqedoninë e Veriut me datë 24.03.2016, me seli në “Partizanski Odredi Blvd” nr. 143, Shkup – Karposh, në pronësi të K.G., i cili sipas pasaportës të lëshuar nga Republika e Serbisë kishte adresë të regjistruar në Gjakovë, Serbi, ndërsa sipas ndryshimeve të bëra me datë 20.06.2023 është bërë ndryshimi i adresës në rr. Faik Konica, nr. 21, Gjakovë -Kosovë.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimeve kontestuese me padi në kuptim të nenit 4 të Ligjit Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund*

të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj ...”

Ky parim përcakton detyrimin e organeve të administratës publike, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, të punojnë dhe vendosin në bazë të Kushtetutës, ligjit, në suaza të kompetencave, si dhe në pajtim me qëllimin për të cilin u janë dhënë ato kompetenca. Pra, organet e administratës publike të cilat zhvillojnë procedurën administrative, kur vendosin në çështje administrative mbi të drejtat, detyrimet ose interesat juridike të individëve, të personave juridik dhe palëve tjera duhet t’i përmbahen LPPA-së dhe të zbatojnë drejtë dispozitat materiale juridike, në bazë të cilave vendoset mbi të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të qytetarëve, të personave juridik ose të palëve tjera.

Në zbatim të parimit të ligjshmërisë, gjykata fillimisht shqyrtoi kompetencën e ARBK për pezullimin e certifikatës së biznesit të shoqërive tregtare për çfarë ju referua nenit 9 par. 1 të LSHT-së i cili përcakton se: *“1. ARBK bën regjistrimin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë, si dhe është e autorizuar për kryerjen e funksioneve të tjera të përcaktuara me këtë Ligj apo funksioneve që i janë caktuar ARBK me ligje të tjera.”* ndërsa lidhur me kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK-së, gjykata ju referua nenit 10 të LSHT-së i cili përcakton se: *“1. Veprimtaria e ARBK drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme që janë përcaktuar në legjislacionin e aplikueshëm për nëpunësit civil. 2. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për administrimin e ARBK, duke përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore. 3. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson ARBK në marrëdhëniet me palët e treta. 4. Drejtori i Përgjithshëm i ARBK ushtron kompetenca drejtuese dhe nxjerr vendime dhe udhëzime të tjera të detyrueshme për rregullimin e procesit të regjistrimit të Shoqërive Tregtare për qendrat e regjistrimit në pajtim të plotë me këtë ligj. Shprehimisht përcaktohet se vendimet dhe udhëzimet e nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i ARBK sipas këtij ligji nuk do të vendosin kërkesa, kushte ose kufizime që nuk janë përcaktuar shprehimisht me këtë ligj. 5. Drejtori i Përgjithshëm i ARBK i raporton Ministrin me shkrim për menaxhimin administrativ, financiar dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve sa herë që i kërkohet, por jo më pak se një herë në vit.”*

Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se ARBK përkatësisht Drejtori i Përgjithshëm ka kompetenca drejtuese për rregullimin e procesit të regjistrimit të Shoqërive Tregtare dhe ka për detyrë të bëjë regjistrimin e shoqërive tregtare ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i ARBK nuk mund të vendos kërkesa, kushte ose kufizime që nuk janë përcaktuar shprehimisht në LSHT, andaj gjykata konstatoi se Drejtori i Përgjithshëm i ARBK-së nuk ka kompetenca në marrjen e vendimeve për pezullimin e certifikatave të bizneseve e që për pasojë kanë humbjen e efektit juridik të

regjistrimit të paditësit në ARKB, në atë mënyrë që paditësi nuk do të mund të ushtronte as veprimtari ekonomike, kjo në kuptim të nenit 4 të LSHT-së i cili përcakton se: *“Veprimtaria Ekonomike në Kosovë mund të ushtrohet vetëm nga Shoqëritë Tregtare të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe me ligj.”*

Andaj, lidhur me këtë, gjykata gjeti se i padituri gabimisht ka aplikuar dispozitat e LSHT duke pezulluar në mënyrë arbitrare certifikatën e biznesit të paditësit “Klan Kosova” kjo për faktin se drejtori i përgjithshëm i ARBK kishte tejkalluar kompetencat me rastin e nxjerrjes së vendimit për pezullimin e certifikatës së biznesit të paditësit, pasi që paditësit i janë vendosur kushte apo kufizime të cilat nuk gjejnë mbështetje ligjore në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe nuk ka paraparë dispozita ligjore të cilat i lë në diskrecion drejtorit të ARBK, të pezulloj certifikatën e bizneseve të regjistruara.

Duke qenë se asnjë dispozitë ligjore nuk përcakton mundësinë e pezullimit të certifikatës së biznesit, gjykata vlerëson se për nga efekti që jep vendimi i nxjerrë nga i padituri në procedurë administrative, i pamundëson shoqërisë tregtare vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, përkatësisht ka për pasojë pushimin e veprimtarisë ekonomike.

Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se personi juridik mund të shuhet, përkatësisht personit juridik mund ti përfundonte veprimtaria ekonomike sipas përcaktimit në statut, aktin themelues apo mbi bazën e ligjit, ashtu që mbi bazën e ligjit personi juridik mund të çregjistrohet, mund të shpërbëhet në mënyrë vullnetare përmes inicimit të procedurës së falimentimit vullnetarë, mund të shuhet përmes inicimit të procedurës së falimentimit jo vullnetar si dhe mund të shuhet si pasojë e kryerjes së ndonjë vepre penale.

Neni 45 i LSHT-së, i cili rregullon procedurën e çregjistrimit të shoqërive tregtare, ndër të tjera paragrafi 4 i këtij neni përcakton se: *“4. Çregjistrimi i Korporatës kryhet përmes plotësimit të formularit ose formularëve përkatës të përgatitur nga ARBK për këtë qëllim, të cilit duhet ti bashkëngjiten si vijon: 4.1. Kopja e dokumentit të identifikimit të Përfaqësuesit të Autorizuar ose Përfaqësuesi me Prokurë; 4.2. Vendimit për çregjistrimin e Korporatës të miratuar në pajtim me Statutin, Marrëveshjen dhe/ose Rregulloret e saj pas përmbylljes së procedurave të shpërbërjes vullnetare ose falimentimit sipas këtij ligji ose ligjit në fuqi për falimentimin; 4.3. Vërtetimi nga autoriteti përkatës tatimor për pagimin e të gjitha borxheve tatimore të mbetura. 4.4. Vërtetimi nga gjykata kompetente së shoqëria tregtare nuk është në procedurë gjyqësore; ...”.*

Po ashtu, neni 112 i LSHT përcakton shkaqet e shpërbërjes vullnetare apo inicimit të procedurës së falimentimit, ku ndër të tjera parasheh se: *“1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar do të shpërbëhet, dhe Veprimtaria e saj Ekonomike do të përmbillet, në rast të: 1.1. skadimit të kohëzgjatjes nëse është përcaktuar me Statut, rrethanave tjera të përcaktuara në Statuti ne Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar që mund të shkaktojë shpërbërjen ose përfundimin e ekzistencës; ose 1.2. vendimit të Kuvendit të Aksionarëve ose Aksionarit të Vetëm të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar për shpërbërjen vullnetare të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. 2. Kuvendi i Aksionarëve ose Aksionari i Vetëm miraton inicimin e procedurës sipas ligjit për falimentimin ose një ligji tjetër të aplikueshëm. 3. Nëse shpërbërja e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar bëhet sipas nën-paragrafëve 1.1 ose 1.2 të paragrafit 1 të këtij neni, Veprimtaria Ekonomike e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar përmbillet dhe asetet shpërndahen sipas këtij Kapitulli. 4. Inicimi i Shpërbërjes Vullnetare ose procedurës së falimentimit sipas ligjit për falimentimin nga Kuvendi i Aksionarëve bëhet përmes votimit unanimit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.”.*

Gjykata po ashtu iu referua dispozitave ligjore të cilat parashohin shuarjen e personit juridik përmes inicimit të procedurës së falimentimit, në përputhje me nenin 18 të Ligjit Nr. 05/L-083 për Falimentimin (LPF), i cili përcakton se: *“1. Një rast konsiderohet se është hapur kur: 1.1. debitori paraqet një kërkesë për inicim vullnetar të riorganizimit ose likuidimit; ose 1.2. është paraqitur një kërkesë jo-vullnetare kundër debitorit, gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore për kërkesën e paraqitur dhe gjykata ka nxjerr aktvendim për pranueshmërinë e kërkesës dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara me këtë ligj.”.*

Gjithashtu, gjykata konstatoi se si formë jo vullnetare e përfundimit të veprimtarisë ekonomike të një shoqërie tregtare është përcaktuar edhe me nenin 8 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale (LPPJVP), ku përcaktohet se: *“2. Llojet e dënimeve që mund të shqiptohen për vepra penale të personit juridik janë: dënimi me gjobë dhe pushimi i personit juridik”, si dhe neni 11 i cili parasheh se: “1. Dënimi me pushim të veprimtarisë së personit juridik, mund të shqiptohet nëse personi juridik është themeluar me qëllim të kryerjes së veprave penale apo veprimtarinë e ka shfrytëzuar kryesisht për kryerjen e veprave penale”.*

Nga dispozitat e cituara më lartë, gjykata konstatoi se ligjet e aplikueshme në Kosovë, si forma të dhunshme të pushimit të veprimtarisë ekonomike të një shoqërie tregtare kanë përcaktuar likuidimin sipas një kërkesë jo vullnetare sipas Ligjit për Falimentimin dhe shqiptimi i dënimit

- pushimi i personit juridik sipas Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale, andaj gjykata gjeti se në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore të elaboruara më lart, për shuarjen e personit juridik dhe se vendimi kontestues nuk është nxjerrë në asnjërin nga bazat e përcaktuara me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Gjykata, po ashtu konstatoi se i padituri në vendimin e shkallës së parë dhe në vendimin e shkallës së dytë i është referuar nenit 85 të LPPA-së si bazë ligjore për pezullimin e certifikatës së biznesit së paditësit, e cila dispozitë përcakton se: *“1. Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit. 2. Kur procedura për zgjidhjen e çështjes paraprake mund të fillojë vetëm me kërkesë të palës, vendimi për pezullimin e procedurës duhet të informojë palën për nevojën e kësaj kërkesë. 3. Kur procedura për zgjidhjen e çështjes paraprake mund të fillohet vetëm sipas detyrës zyrtare nga organi tjetër, organi për zgjidhjen e çështjes do të kërkojë nga organi tjetër fillimin e procedurës për zgjidhjen e çështjes paraprake.”* Gjykata nga provat e administruara në këtë çështje ka konstatuar se objekt shqyrtimi në procedurë administrative ka qenë ndryshimi i adresës së pronarit të shoqërisë “KGO Media Investments” LLCSP me seli në Shkup, Maqedoni e Veriut, e cila është pronare e vetme e shoqërisë “KGO Media Investments Holding” SH.P.K. me seli në Prishtinë dhe asnjëherë certifikata e regjistrimit të biznesit të shoqërisë “Klan Kosova” SH.P.K., e cila është në pronësi të shoqërisë “KGO Media Investments Holding” SH.P.K., andaj gjykata në këtë rast nuk gjeti rrethana nën të cilat ka mundur të aplikohet neni 85 i LPPA-së përkatësisht nuk ka pasur bazë ligjore për pezullimin e certifikatës së biznesit të paditësit duke u bazuar në nenin 85 të LPPA-së.

Përveç kësaj, gjykata vlerëson se neni 75 par. 1 i LSHT përcakton se: *“1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është vetvetiu bartëse e te drejtave dhe obligimeve.”* ashtu që përgjegjësia e shoqërisë “Klan Kosova” Sh.p.k. është juridikisht e ndarë nga përgjegjësia e aksionarit të saj “KGO Media Investments Holding” SH.P.K., rrjedhimisht, gabimet në regjistrim lidhur me aksionarin e “KGO Media Investments Holding” SH.P.K. nuk kanë mundur të barten shoqërisë “Klan Kosova” SH.P.K.

Lidhur me pretendimet e të paditurit se paditësi ka cenuar rendin juridik të Republikës së Kosovës, duke paraqitur Komunën e Pejës dhe Komunën e Gjakovës nën administrimin e Republikës së Serbisë, gjykata vlerëson se i padituri me rastin e regjistrimit të ndryshimeve në biznes, ka pasur mundësi që të refuzoj regjistrimin e ndryshimeve në biznes të bëra sipas aplikacionit të datës 31.01.2014 dhe aplikacionit të datës 27.04.2020 ku në të dy rastet është dorëzuar pasaporta e lëshuar nga Republika e Serbisë për pronarët e shoqërisë “KGO Media Investments” LLCSP me seli në Shkup. Neni 17 par. 7 i LSHT-së përcakton se: *“7. Nëse aplikimi për regjistrim, çregjistrim apo ndryshim të të dhënave në Regjistër nuk përmbush kërkesat e këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër në fuqi, si dhe për shkak të kësaj mos përmbushjeje, nuk mund të regjistrohet brenda dy (2) ditësh pune nga data e pranimit, ARBK-ja njofton Përfaqësuesin e Autorizuar ose Përfaqësuesin me Prokurë për këtë fakt, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe cakton një afat jo më të gjatë se dhjetë (10) ditë pune për korrigjimin e mangësisë(ve). Nëse këto mangësi nuk korrigjohen deri në fund të afatit, ARBK-ja mund të refuzojë përmbylljen e aplikimit.”* Në të kundërtën, nëse gabimet e bëra gjatë procedurës së regjistrimit nuk janë vënë re nga ana e të paditurit, i njëjti ka qenë dashur të veproj konform kërkesës për korrigjim, në të cilën paditësi ka bërë përmirësimin e gabimit, në përputhje me nenin 21 par. 2, 3 dhe 4 të LSHT, i cili përcakton se: *“2. Një Shoqëri Tregtare mund t’i korrigjojë gabimet e saj në çdo kohë me paraqitjen e kërkesës gjegjëse në ARBK. 3. Nëse ARBK-ja ka informata në lidhje me pasaktësinë e një të dhëne të regjistruar apo që një e dhënë mungon, ARBK bën kërkimet e duhura. 4. Pas vërtetimit që të dhënat në Regjistër janë të pasakta apo mungojnë, ARBK-ja njofton Shoqërinë Tregtare në aplikimin e së cilës duhet bërë regjistrimi. Nëse nuk ka kundërshtim ndaj regjistrimit apo korrigjimit të informatave brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas atij njoftimi, ARBK-ja bën regjistrimin apo korrigjon të dhënat. Pas pranimit të kundërshtimit, ARBK-ja vendos nëse ai kundërshtim ka bazë.”*

Po ashtu gjykata konstatoi se në rastet e cenimit të rendin juridik të Republikës së Kosovës nga një person juridik, duhet të veprohet në bazë të Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale, në bazë të cilit ligj një shoqërie tregtare mund ti shqiptohen sanksionet e përcaktuara me këtë ligj e që përfshinë edhe pushimin e personit juridik në rast të plotësimin të kushteve të përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji.

Prandaj, gjykata vlerëson se duke qenë se vetë ARBK kishte toleruar - aprovuar regjistrimin e ndryshimeve me informata të tilla, është dashur të ndjek procedurën për korrigjim të gabimeve në shoqërinë të cilat janë regjistruar ato gabime, përkatësisht të lë në fuqi ndryshimet që janë

bërë sipas Vendimit nr. 333 të datës 21.06.2023 dhe në asnjë formë nuk ka pasur bazë ligjore që të bëjë pezullimin e certifikatës së biznesit, veprim ky po ashtu në kundërshtim me nenin 8 par. 1 të LPPA-së i cili përcakton se: *“1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave.”* pasi që në rastet kur tolerohet – aprovohet një veprim nga organi administrativ, pasojat duhet të jenë të parashikueshme dhe në kuadër të pritshmërive ligjore dhe në asnjë formë me veprime që nuk gjejnë bazë ligjore.

Po ashtu gjykata në kuptim të nenit 52 të LPPA-së, i cili përcakton se: *“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit”,* gjeti se Vendimi Nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 dhe Vendimi Nr. 309/11 i datës 14.06.2023 të nxjerra nga Agjencia për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë, duhet të anulohen pasi që të njëjtat janë nxjerrë në mungesë të kompetencës, në kundërshtim me ligjin material dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit.

Prandaj, mbështetur në arsyet e cekura më lartë, gjykata vendosi që të anuloj Vendimin Nr. 4566/01 të datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimin Nr. 309/11 të datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, mbështetur në nenin 46 par. 4 të LKA-së i cili përcakton se: *“4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”.*

Pasi që gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar, gjykata la në fuqi shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 309/11 i datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.315/23 i datës 02.08.2023, deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.315/23, datë 13.03.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimi, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.315/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Klan Kosova Sh.p.k., me seli në Zonën Industriale, ish – Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “S...” Sh.p.k. me seli në Veternik, kompleksi banesor EXDC3, blloku 10, kati VI, nr.18, Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, me seli në rr. “Abënor e Astrit Dehari”, nr. 21, Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të Vendimit nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 309/11 i datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë, duke vendosur sipas kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve kontestuese, jashtë seancës, më datë 02.08.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesa e paditësit Klan Kosova Sh.p.k., për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve.
- II. SHTYHET ekzekutimi i Vendimit nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 309/11 i datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi Klan Kosova Sh.p.k., me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e Vendimit nr. 4566/01 të datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 309/11 të datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e

Bizneseve në Kosovë, si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të tyre, deri në marrjen e vendimit gjyqësor përfundimtar për padi.

Paditësi, në kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të lartcekura, lidhur me plotësimin e kushteve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve ka theksuar se paditësi është një ndër ofruesit e shërbimeve mediale audio – vizuale me mbulimin më të madh në Kosovë dhe e licencuar pranë Komisionit të Pavarur për Media, si dhe një nga punëdhënësit më të mëdhenj në fushë e mediave me rreth 220 të punësuar dhe qindra bashkëpunëtor komercial, andaj ekzekutimi i vendimit për pezullimin e certifikatës së biznesit paditësit do ti shkaktonte dëm vështirë të riparueshëm për faktin se paditësit do ti humbte licenca e operimit, rreth 220 punëtorë do të mbeteshin pa punë si dhe do të dështonte në përmbushjen e obligimeve kontraktuale që ka, e të gjitha këto do të sjellin dëm të pa-riparueshëm ekonomik. Ka shtuar se ekzekutimi i vendimit do të kishte për pasojë shkaktimin e dëmit të imazhit të paditësit e rrjedhimisht humbjen e kredibilitetit si një ndër mediumet më të mirëfillta në vend. Lidhur me plotësimin e kushtit të dytë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese ka theksuar se fakti se qasja në informacionin e siguruar nga mediat apo në këtë rast nga ana e paditësit është interes publik, vërtetohet edhe nga fakti që informimi nga mediat lidhet ngushtë me lirinë e shtypit e cila është një e drejtë kushtetuese e garantuar në shumicën e vendeve demokratike si dhe me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe me Direktivën Evropiane 2010/13/EU për shërbyesit medial dhe audio-vizual e cila e garanton dhe e cilëson të drejtën e informimit si interes juridik dhe publik, andaj shtyrja e ekzekutimit të vendimeve nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik, përkundrazi shtyrja e ekzekutimit të vendimeve do të ishte në të mirë të përgjithshme dhe në të mirë të interesit publik dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk do ti shkaktonte asnjë dëm të paditurit. Ka shtuar se KGO Media Investments Holding Sh.p.k. është aksionar i vetëm i paditësit dhe se paditësi nuk është në pronësi direkte të kompanisë me seli në Shkup dhe se informatat mbi adresën dhe shtetësinë e pronarit të kompanisë me seli në Shkup janë ndryshuar menjëherë dhe të njëjtat janë dorëzuar me datë 21.06.2023 në ARBK. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kërkesa e paditësit dhe të shtyhet ekzekutimi i Vendimit nr. 309/11 i datës 14.06.2023 dhe Vendimit nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 të lëshuara nga i padituri Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Me qëllim të vlerësimit të kësaj kërkesë, gjykata ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *“Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta*

shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar". Po ashtu në paragrafin 6 përcaktohet se *"Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni"* dhe nenit 27 par. 1 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale i cili përcakton se *"Jo më vonë se tre (3) ditë nga marrja e një kërkesë për masë të përkohshme ose lehtësim tjetër urgjent, në përputhje me ligjet në fuqi, dhoma e shkallës së parë e konsideron dhe vendos për një kërkesë të tillë pa dëgjim të palëve në seancë"*.

Bazuar në nenin 22 par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik; c) shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Gjykata pasi vlerësoi kërkesën e paditësit, shkresat e lëndës, por edhe përmbajtjen e vendimeve kontestuese, konstatoi se i padituri me Vendimin nr. 309/11 të datës 14.06.2023 ka vendosur që të pezulloj certifikatën e biznesit të kompanisë "Klan Kosova" Sh.p.k. me NUI 810795297 të datës 29.05.2020 dhe me Vendimin për Korrigjim nr. 311 të datës 15.06.2023 ka bërë korrigjimin e bazës ligjore të vendimit nr. 309/11 të datës 14.06.2023, ndërsa me vendimin nr. 333 të datës 21.06.2023 duke vepruar sipas detyrës zyrtare i padituri ka shfuqizuar vendimin nr. 309/11 të datës 14.06.2023. Po ashtu i padituri përsëri duke vepruar sipas detyrës zyrtare me vendimin nr. 336 të datës 21.06.2023 ka anuluar vendimin nr. 333 të datës 21.06.2023, ka lënë në fuqi Vendimin nr. 309 të datës 14.06.2023 dhe Vendimin nr. 311 të datës 15.06.2023. Po ashtu gjykata konstatoi se me Vendimin nr. 4566/01 të datës 28.07.2023 është refuzuar ankesa e paditësit e parashtruar me datë 11.07.2023 dhe është në lënë në fuqi Vendimi i ARBK-së me nr. 309/11 i datës 14.06.2023 me arsyetimin se paditësi me rastin e regjistrimit në periudha të ndryshme kohore disa herë ka ofruar dokumentacionin i cili në përmbajtje është në kundërshtim me Ligjin për Shoqëri Tregtare si dhe me aktet nënligjore për regjistrimin e bizneseve dhe se nga regjistri elektronik i nxjerrë nga regjistri i bizneseve të Republikës së Maqedonisë së Veriut të dhënat për pronarin e vërtetë nuk janë reflektuar ndryshimet, por ende figurojnë të dhënat për pronarin e vërtetë siç është: Shteti – Serbi, Shtetësia – Kosovë dhe se dokumenti nr. 2008-50/155020230079177 i nxjerrë me datë 28.07.2023 nuk ka reflektuar të dhënat për pronarin e vërtetë.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e paditësit të paraqitura në kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese dhe vlerësoi se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që paditësi ka argumentuar faktin se ekzekutimi i vendimeve do të sillte dëm i cili vështirë do të riparohet, si dhe ka argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Gjykata vlerëson se ekzekutimi i vendimeve kontestuese paditësit do të sillte dëme vështirë të riparueshme pasi që ekzekutimi i vendimit për pezullimin e certifikatës së biznesit në parim e pezullon dhe e lë pa efekt regjistrimin e paditësit si person juridik, i cili regjistrim sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare i jep të drejtën për të ushtruar veprimtari ekonomike në Kosovë. Gjykata po ashtu vlerëson se për shkak të pezullimit, certifikata e biznesit e humb efektin juridik, e për pasoj edhe regjistrimi i paditësit në ARKB, andaj paditësi nuk mund të ushtroj as veprimtari tjetër ekonomike për shkak të certifikatës së pezulluar, i cili pezullim ka për efekt shuarjen/ndalimin e çfarëdo veprimtarie të paditësit. Si rrjedhojë, pezullimi i certifikatës së biznesit do të rezultonte në revokimin e licencës nga Komisioni i Pavarur i Mediave për ushtrimin e funksionit të ofruesit të shërbimeve mediale audiovizuale që paraqet aktivitetin kryesor biznesor të paditësit, e cila do të kishte për pasojë ndërprerjen e marrëdhënies së punës për rreth 220 të punësuar tek paditësi sipas listës së të punësuarve të bashkangjitur me padi si dhe ndërprerjen e marrëdhënieve tjera kontraktuale me palët e treta, rrethana këto që në rast të ekzekutimit të vendimeve kontestuese paditësit do të sillnin dëme vështirë të riparueshme.

Gjykata gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se paditësi ka bërë përmirësimet e nevojshme në shoqërinë tregtare të regjistruar në Maqedoninë e Veriut, ashtu që sipas Certifikatës së Regjistrimit nr. ser. 10076953 dhe informatat e biznesit të lëshuara me datë 21.06.2023, “Klan Kosova” Sh.p.k. është shoqëri tregtare e regjistruar në Kosovë me datë 26.11.2008, me numër unik identifikues 810795297 me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë, në pronësi të KGO Media Investments Holding me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë dhe person të autorizuar B.I. me adresë rr. “...” nr....., Pejë, Kosova. Sipas Certifikatës së Regjistrimit nr. ser. 10114386 dhe informatat e biznesit të lëshuara me datë 21.06.2023 për shoqërinë KGO Media Investments Holding Sh.p.k., konstatoi se e njëjta është shoqëri tregtare e regjistruar në Kosovë me datë 31.05.2021 me numër unik identifikues 811575804 me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e

Amortizatorëve, Prishtinë, në pronësi të KGO Media Investments LLCSP, me seli në Karposh Partinzanski Odredi Blvd, nr. 143, Shkup, Maqedoni e Veriut dhe me person të autorizuar K.G. me adresë rr. “...” nr..., Gjakovë, Kosova. Sipas Dokumentit nr. 0805-50/150120230016866 i datës 20.06.2023, gjykata konstatoi se shoqëria KGO Media Investments LLCSP, është shoqëri tregtare e regjistruar në Maqedoninë e Veriut me datë 24.03.2016, me seli në “Partizanski Odredi Blvd” nr. 143, Shkup – Karposh, në pronësi të K.G., me adresë në rr. ..., nr..., Gjakovë, Kosovë.

Meqenëse në rastin konkret sipas certifikatave të përshkruara më lartë, rezulton se paditësit ka bërë ndryshimet në regjistrat e biznesit në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë, gjykata vlerësoi se shtyrja e ekzekutimit të vendimeve kontestuese nuk bie ndesh me interesin publik.

Gjykata po ashtu vlerëson faktin se paditësi e ushtron funksionin e ofruesit të shërbimeve mediale audiovizuale dhe përderisa vazhdimi i ushtrimit të njëjtit funksion nuk përbën shkelje të interesit publik, gjykata në këtë rast vlerëson se mos shtyrja e ekzekutimit të vendimeve kontestuese do të ishte pikërisht në kundërshtim me interesin publik dhe garancioneve që përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë për lirinë e mediave.

Lidhur me plotësimin e kushtit të tretë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese, përkatësisht dëmit që mund ti shkaktohet palës së paditur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese, gjykata vlerëson se nuk ekziston ndonjë rrethanë sipas të cilës të paditurit do ti shkaktohej ndonjë dëm nga shtyrja e ekzekutimit të vendimeve kontestuese.

Andaj, për ta shmangur rrezikun e dëmit që mund të i shkaktohet paditësit në rast të ekzekutimit të vendimeve të lartcekura dhe duke pasur parasysh faktin se shtyrja e ekzekutimit të tyre nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe palës kundërshtare nuk i shkakton ndonjë dëm, gjykata vendosi ta aprovoj kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor, sipas padisë së ushtruar nga paditësi.

Këtë vlerësim gjykata e mbështeti në faktin se paditësi ka dhënë prova dhe argumente konkrete e të mjaftueshme se bazuar në dispozitat e cekura më lartë, janë përmbushur në mënyrë kumulative kushtet ligjore që të aprovohet kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të kontestuara derisa gjykata të vendos përfundimisht lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të kontestuara përkitazi me padinë e paditësi ku do të shqyrtohen të gjitha pretendimet e palëve të paraqitura dhe që do të paraqiten në ardhmen.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 22 par. 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë
Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.315/23, datë 02.08.2023

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.